- *NS-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxteri, mirembajtja e tyre.*
- *NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë levizëse, transportues).*
- *NS-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.*
- *NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe kondicionimit.*
- *NS-14 A Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV, etj.*

sipas modelit të lëshuar nga MTI;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastruktures ne Republikën e Shqipërisë, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

5. Certifikatat me të cilat duhet të jetë e pajisur Shoqëria:

Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat:

- a) Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten **ISO 9001** "Sistemet e menaxhimit te cilesise", (e vlefshme). Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- b) Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten **ISO 14001** "Sistemet e menaxhimit te ambientit", (e vlefshme). Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i

akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

- c) Shoqëria duhet të paraqesë certifikatën **OHSAS 18001** “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së punetoreve në punë”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë

6. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamiona veteshkarkues 5-10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamioncine 3-5 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
Motobetoniere te vogla	1 copë	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	2 cope	Pronësi ose me qera
Pompe Uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe suvatimi	1 cope	Pronësi ose me qera
Skela	1000 m 2	Pronësi ose me qera
Eskavator me rrota ose zinxhir me kapak kove 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc karrel portativ i levizshem me kapacitet 0.5-1 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Depozite uji 5000 litra	1 copë	Pronësi ose me qera

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton pronesine (certifikata e pronesise), regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerës/furnizimit. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

_____ etj.

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP².

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

² Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

Shtojca 8/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

**DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE
LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS**

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik]

FORMULAR VLERËSIMI

(Ky formular do të shoqërohet me Akt kolaudimin dhe situacionet)

Autoriteti kontraktor/Investitori	
Adresa/Tel.	
Emri i Titullarit/Administratorit	
VËRTETOJ SE:	
Autoriteti kontraktor/Investitori ka nënshkruar kontratën me	
Emri i operatorit NIPT/ Bashkimit të operatorëve NIPTET/ Nënkontraktoret NIPTET	
Adresa/t	
Objekti i kontratës:	
Data e fillimit të kontratës	Data e mbarimit të kontratës
Vlera sipas kontratës	Vlera e realizuar
% e bashkimit të O.E. dhe përshkrimi i punëve të kryera nga secili anëtar	
Nënkontraktoret.	
Vlerësimi	(shprehur me fjalë)
	E përmbushur
	E papërmbushur
Firma	
Vula e Autoritetit Kontraktor	

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

MBI DISPONIMIN E MAKINERIVE

Operatori ekonomik: _____

Deklaroj se zotëroj mjetet pajisjet teknike dhe asete të tjera fizike për të realizuar kontratën me objekt: _____

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				
2				
3				
4				
5				

Dhe

Me qera					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

- shto/fshi rreshta të tjerë nëse nevojitet.

Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)

Emri:

Adresa:

Nr. Telefonit:

Faks:

E-mail:

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROCËS³

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj se kam në proces dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

³ Kjo deklaratë ka si qëllim plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

Shtojca 12

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektivit etj:

Sipas aneksit bashkelidhur DST

Specifikimet Teknike të Materialeve:

I-Tualetet e reja

-Mur ndarës me tulla me vrima 10 cm

Murature me tulla me 6 vrima, me trashësi 10 cm dhe llaç bastard m-25 sipas pikes 1.2, me dozim për m³: tulla me 6 vrima nr.177, llaç m³ 0.10, çimento 400 kg 14 dhe uje, përfshirë çdo mjeshteri për dhembët e lidhjeve, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelat e shërbimit dhe çdo gje tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj në mënyrë perfekte. Për muraturen e katit përdhe sipërfaqja e themelit duhet të jetë e niveluar me një shtresë llaçi çimento 1:2 me trashësi 2 cm.

-Hidroizolimi i dyshemeve

Hidroizolimi i dyshemeve në ndërkate bëhet me shtresë hidro izoluese, mbi sipërfaqe të tharë dhe të niveluar mirë, duke përfshirë pjesën vertikale, trajtuar me një dorë praimer, e përbërë nga dy membrana guaine të formuar nga një shtresë fibre prej leshi xhami e bitumi, me trashësi 3 mm secila, të vendosura në vepër me flakë, të kryqëzuara mbi sipërfaqe të ashpër, të pjerrët ose vertikale, duke realizuar mbivendosjen e shtresave (minimumi prej 12 cm) si dhe të ngrihet në drejtimin vertikal në muret anësorë me min. 10 cm.

- Suvatim i brendshëm

Sprucim i mureve dhe tavaneve, me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe riforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e sherbimit dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund sprucimit. Suvatim i realizuar nga një Shtresë me trashësi 2 cm Llaçi bastard m-25 me dozim për m²: rërë e lare m³ 0,005, Llaç gelqereje m-1:2 m³ 0.03, çimento 400 kg 6.6, uje, i aplikuar, me paravendosje të drejtuesve në mure, dhe e lemuar me mistri e berdaf, duke përfshirë skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ti dhënë plotësisht fund suvatimit në mënyrë perfekte.

-Veshje me pllaka porcelanat

Veshje për një lartësi 2 m të mureve, me pllaka porcelanat me dimensione të ndryshme të cilësive se pare, furnizuar dhe vendosur në vepër mbi një sipërfaqen e përgatitur me pare, e ngjitur me llaç me dozim në m²: rërë e lare m³ 0,005, çimento 400 kg 4, stukim me çimento të bardhë, pastrim i plote, skelat e sherbimit si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e veshjes në mënyrë perfekte.

II-Punime fasade dhe të ndryshme

- Bojatisje me bojë hidroplastike

Lyerje me bojë hidro-plastike e sipërfaqeve të brendshme/jashtme.

Proçesi i lyerjes me bojë plastike i sipërfaqeve të mureve të brendshme kalon nëpër tre faza si më poshtë:

1-Përgatitja e sipërfaqes që do të lyhet. Para lyerjes duhet të bëhet pastrimi i sipërfaqes, mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me ane të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për paralyerje. Në rastet e sipërfaqeve të patinuara bëhet një pastrim i kujdesshëm i sipërfaqes. Para fillimit të proçesit të lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse.

2- Paralyerja e sipërfaqes së brendshme/jashtme të pastruar. Në fillim të proçesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me vinovil të holluar (Astar plastik).Për paralyerjen bëhet përzierja e 1 kg vinovil me 2.5-3 litra ujë.Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë.Norma e përdorimit është 1 litër përzierje vinovil me ujë duhet të përdoret për 20 m² sipërfaqe.

3- Lyerja me bojë hidroplastike e sipërfaqeve të brendshme/jashtme. Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës plastike e cila është e paketuar në kuti 5 litërshe.Lëngu i bojës hollohet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje i hidhet pigmenti derisa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë plastike e holluar duhet të përdoret për 4-5 m² sipërfaqe. Kjo normë varet ashpërsia e sipërfaqes së lyer.

- Patinimi

Patinurë muri realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të svatuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m². Lartësia e patinurave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinurën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje. Patinimi është proces i domosdoshëm të kryhet mbi elementet e gipsit neper ambjnetet e brendshme.

- Struktura metalike

Në projektimin e konstruksioneve prej çeliku, duhen marrë parasysh kërkesat që pasqyrojnë veçoritë e punës së këtyre konstruksioneve, më anë të udhëzimeve përkatëse në mbështetje të këtyre kushteve teknike. Soliditeti dhe qëndrueshmëria e konstruksioneve prej çeliku duhet të garantohet si gjatë procesit të shfrytëzimit, ashtu edhe gjatë transportimit dhe montimit.

Prodhimi

Prodhimi i çelikut duhet të jetë bërë nga kompani të licensuara dhe ata duhet të garantojnë për cilësinë si dhe të dhënat (përbërja kimike, karakteristikat e forcës/bajtëse, etj) e çelikut. Çeliku që përdoret për konstruksionet mbajtëse, duhet t'u përgjigjet kërkesave të standarteve dhe kushteve teknike përkatëse dhe të ketë garanci përse i përket kufirit të rrjedhshmërisë dhe përmbajtjes max. të squfurit dhe fosforit; kurse për konstruksionet e salduara, edhe për përmbajtjen max. të karbonit. Prerja, saldimi si dhe lidhja e elementeve prej çeliku bëhet në kantierin e firmës kontraktuese dhe ata transportohen në kantier ose këto punime mund të bëhen në vëndin e punës (në objekt). Sidoqoftë, duhet që punimet para montimit të elementeve të kontrollohen nga Supervizori dhe duhet të protokollohen.

Saldimi

Përgatitja për saldimit përfshin atë që detajet para se të saldohen, të kenë marrë formën e tyre përfundimtare. Po ashtu, buzët dhe sipërfaqet e pjesëve që do të saldohen duhet të përgatiten sipas kërkesave të procedurës së saldimit dhe formave që jepen në pasqyrat 6, 7, 8 të K.T.Z. 206-80 ose në ndonjë tjetër normë/standart evropian. Pas saldimit, detajet duhet të trajtohen termikisht për të zvogëluar ndarjet e brendshme, për të mënjeluar të plasurat dhe për të përmisuar vetitë fiziko-mekanike. Gjatë zbatimit të punimeve për saldimitin e çelikeve duhet të mbahet dokumentacioni teknik më të dhëna për certifikatën e materialeve të përdorura, ditarin e punimeve, etj.

- Gips cimentato

Pllake gipsi kundra lageshtires

Panele gipsi kundra lageshtires (klasifikimi DIN 18180 GKI) për përdorim të brendshëm me trashësi 12,5 mm, me përbërje CaSO₄·2H₂O me absorbimin specifik ndaj lageshtires duhet të ketë parametrat e mëposhtme: Reagimin ndaj zjarrit, klasa EN 13501-1: A2-s1, d0, Rezistence ndaj faktorëve të avullit të ujit μ: 10 (thatë), 4 (njomë), Përçim termik λ: 0,20 W/mK, Densiteti: ≥ 760 kg/m Peshë e pllakës ≥ 9,5 kg/m², Peshë e përkuljes ≥ 550 N për së gjati dhe ≥ 210 N transversale Absorbimi i ujit pas dy orë zhytje totale të jetë jo më shumë se < 10% e peshës së pllakës.

- Pllakë çimento e jashtme Aquapanel

Aquapanel Exterior është një pllakë e ashpër çimentoje, për përdorim të jashtëm. Ajo është e përbërë prej çimentos Portland dhe një rrjetë të përbërë prej fibre qelqi, të mbështjella në sipërfaqet e pasme dhe të përparme, me trajtim të veçantë të reduktimit të absorbimit të ujit. Fundet janë me seksion katror dhe skajet janë të përforcuara dhe rifinuara pa probleme.

III- Paisjet hidrosanitare (WC, Lavaman, Dushe)

WC TUALETI

Setet e WC janë tualete sanitare porcelani me materiale porcelani në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë ISO 9001, sipas përshkrimit në Skicat Teknike nga projektuesi. Tipi i WC mund të jetë modern (alla frënga) i llojit i varur. Ata do të vendosen në përputhje me kërkesat e Mbikëqyrësit.

Setet e WC-ve, të llojit modern (alla frënga) do të fiksohen mirë në mur, pa krijuar të çara në pllakat e murit. Seti i WC-së do të lidhet me tubat e shkarkimit para instalimit në mur me kapëse tunxhi. Tubi shkarkues i WC-së mund të jetë ose poshtë setit ose në pjesën e pasme të tij. Set i WC-së me dalje shkarkimi anësore duhet të jetë 19 cm mbi nivelin e dyshemesë.

Në pjesën më të poshtme të basenit mbledhës do të jetë një piletë me diametër minimal $D = 90$ mm. Pjesa e sipërme e WC-së mund të jetë ovale ose rrethore në përputhje me kërkesat e projektit dhe llojit të setit të WC-së. Lartësia e setit të WC-së, lloji modern, është 38-40 cm. Ato do të instalohen në përputhje me projektin dhe kërkesat e Mbikëqyrësit. Distanca Horizontale midis seteve të WC-ve dhe pajisjeve të tjera sanitare (lavaman, bide, etj) duhet të jetë më e pakta 30 cm.

Setet e WC-ve duhet të sigurojnë rrjedhë uji të shpejtë dhe në sasi të madhe. Ato duhet të jenë rezistente ndaj mbylljeve mekanike, gërryerjes dhe agjentëve kimikë. Ato duhet të sigurojnë izolim të ujit, kushte të mira gjatë funksionimit dhe akses të lehtë për riparim.

Seti i WC-së duhet të lidhet me tubat e shkarkimit të ujërave të zeza (lidhja do të realizohet me një ub tip sifoni). Lidhja e tubave me setin e WC duhet të jetë me tuba PVC (të të njëjtave karakteristika si tubat e tjerë të ujërave të zeza). Diametri i tyre duhet të jetë në përputhje me daljen e setit të WC-së (zakonisht diametri i tyre është 100-110 mm).

Seti i WC-së do të lidhet me sistemin e ujit të pijshëm. Lidhja do të bëhet në një kuti shkarkimi që mund të instalohet drejtpërdrejt mbi setin e WC-së ose në mur (e ndarë nga seti i WC-së). Kjo do të varet nga seti i WC-së. Kutia e shkarkimit do të instalohet në nivelin 1,5 m lart nga niveli i dyshemesë. Kutia e shkarkimit prej material porcelani do të jetë në përputhje me projektin dhe standardet e cilësisë ISO me kërkesat. Tubi i ujërave të zeza do të fiksohet në mur çdo 50 cm.

Duhet të përfshihen të gjitha kërkesat teknike të mbikëqyrësit për ta përfunduar punën klasi i parë. Lidhja e setit të WC me tubat e ujërave të zeza duhet të bëhet me materiale të posaçme për tuba PP në përputhje me rekomandimin e prodhuesit të tubave. Mostra e setit WC së bashku me certifikatën e cilësisë, certifikatën e origjinës, certifikatën e testimit dhe certifikatën e garancisë do t'i dërgohen mbikëqyrësit për miratim paraprak para instalimit të WC-së. Të dhënat teknike të

setit të WC-së (përfshirë llojin e WC-së, presionin punues, emrin e prodhuesit, standardet dhe vitin e prodhimit) duhet të jepen në katalog. Mbikëqyrësi mund të kryejë një testim shtesë për të dhëna mekanike dhe fizike.

LAVAMANI I TUALETIT

Në dhomat e Tualetit dhe hapësirat e larjes janë parashikuar sete me lavamanë. Setet e lavamanëve janë pajisje sanitare për larjen e duarve, fytyrës, etj. Setet e lavamanëve mund të jenë prej metali, porcelani, ose in site. Setet e lavamanëve duhet të sigurojnë rrjedhë uji të shpejtë dhe në sasi të madhe. Ato duhet të jenë rezistente ndaj mbylljeve mekanike, gërryerjes dhe agjentëve kimikë. Ato duhet të sigurojnë izolim të ujit, izolim akustik, dhe kushte të mira gjatë funksionimit dhe akses të lehtë për riparim. Seti i lavamanit duhet të lidhet me tubat e shkarkimit të ujërave të zeza (lidhja do të realizohet me një tub tip sifoni). Lidhja e mësipërme do të bëhet me nyja, tip T, me 45 ose 60 gradë. Lidhja e tubave me setin e lavamanit duhet të jetë me tuba HDPE (të të njëjtave karakteristika si tubat e tjerë të ujërave të zeza). Gjatësia duhet të jetë 20 - 40 cm dhe diametri duhet të përputhet me daljen e setit të lavamanit. Seti i lavamanit do të lidhet me sistemin e ujit të pijshëm. Lidhja do të realizohet me dy tuba fresibël me gjatësi 30-50 cm de diametër OD=1/2". Tubat do të realizojnë lidhjen e valvulave me tubat e sistemit të ujit të ngrohtë dhe të ftohtë.

DUSHI NË NIVEL DYSHEMEJE

Në dhomat e Tualetit dhe hapësirat e larjes duhet të parashikohen sete dushi. Setet e dushit janë tualete sanitare prej porcelani. Kjo do të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë ISO 9001, sipas përcaktimeve në Skicat Teknike nga projektuesi. Ata do të vendosen në përputhje me kërkesat e Mbikëqyrësit. Setet e dusheve duhet të sigurojnë rrjedhë uji të shpejtë dhe në sasi të madhe. Ato duhet të jenë rezistente ndaj mbylljeve mekanike, gërryerjes dhe agjentëve kimikë. Ato duhet të sigurojnë izolim të ujit, kushte të mira gjatë funksionimit dhe akses të lehtë për riparim. Setet e dushit duhet të fiksohen mirë në dysheme me kapëse tunxhi dhe tapa vidash dhe vida, pa krijuar të çara në pllakat e murit. Pas instalimit të seteve të dushit, duhet të instalohet një rubinet ndalimi tunxhi, dhe grup dushi në mur.

IV-Rrjeti i shpërndarjes së ujit të ftohtë sanitar

Rrjeti i shpërndarjes është rrjeti që shpërndan ujin nga grupi i presurizimit deri në konsumatorë nëpërmjet një rrjeti të destinuar për këtë qëllim. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga një linjë kryesore që vjen nga stacioni i pompimit nga ambienti teknik, e cila furnizon kollonat kryesore të shpërndarjes në godinën e maternitetit, spitalit dhe poliambulances, nga të cilat dalin degëzimet magjistrale për çdo kat. Çdo degëzim nga magjistrali kryesor shërben si degë furnizimi për një sektorë të caktuar të pajisura me një valvul ndërprerëse, për të ndërprerë prurjen e ujit në rastet kur kërkohet të ndërhyhet në sistem pa ndërprerë furnizim e konsumatorëve të tjerë. Sistemi i tubave të ujit sanitar plotëson të gjitha kërkesat e normave dhe standarteve të përcaktuara, në përputhje me specifikimet teknike përkatëse.

- Per mbushjen me uje te sistemit, provat nen presion statik dhe te punes te tubacioneve zbatuesi do tja paraqese supervizorit apo drejtuesit teknik te kantierit proçeduren dhe pajisjet e kryerjes se ketyre proceseve si dhe do te dokumentoje rezultatet e arritura nepermjet testeve ose proces verbaleve ne rast te hasjes se problemeve.
- Instalimi i pompave duhet te behet duke respektuar skedat teknike te tyre dhe kushtet teknike te instalimit sipas rekomandimeve te prodhuesit dhe ne perputhje me kerkesat e projektit.
- Pas instalimit te pompave sugjerojme qe firma zbatuese perpara kryerjes se provave te tyre te verifikoje nga specialistet e prodhuesit respektimin e kushteve dhe rekomandimeve te kerkuara nga prodhuesi. Provat e pompave te kryhen ne prani te specialisteve te prodhuesit dhe te merren ne dorezim nepermjet dokumentacionit te testeve perkatese.
- Per proceduren e testeve zbatuesi do tja paraqes supervizorit apo drejtuesit teknik te kantierit proçeduren dhe pajisjet e kryerjes se ketyre proceseve si dhe do te dokumentoje rezultatet e arritura nepermjet testeve ose procesverbaleve ne rast te hasjes se problemeve
- Per realizimin e impiantit hidraulik te furnizimit me uje inxhinieri mekanik i zbatuesit duhet te perputhe projektin mekanik me projektin e forometrise te strukturave ndertimore perpara ekzekutimit te punimeve te betonimit ose te penimeve te rikonstruksionit. Inxhinieri mekanik instalator përfaqesues i kontraktorit duhet të garantoj respektimin e të gjitha kërkesave mekanike pozicionet, dimesionet e forometrive në strukturat horizontale dhe vertikale.

V-Impanti gazit mjeksor

Impianti i gazit mjeksor në vetvete përfshin sistemin e shpërndarjes së gazrave si: oksigjeni (O₂), ajri medikal (CA), vakuumi (V) dhe gazi narkotik-protoksidi i azotit (N₂O) në mënyrë të specifikuar në kërkesat medikale për çdo ambient mjekësor sipas kërkesave normative Europiane, pamvaresisht përdorimit te metodave alternative te anestezisë etj.

Këto sisteme respektivisht janë të përbërë nga impianti teknik, i cili është vendosur në ambientin teknik. Në këtë ambient është parashikuar centrali i ajrit mjeksor dhe centrali i vakumit, ndërsa rezervuari i oksigjenit është parashikuar në plansistemim sipas normave te sigurise. Temperatura e ambientit në të cilat janë pozicionuar cilindrat e depozitave nuk i kalon 50 °C, ndërsa temperatura e ambientit në të cilin është pozicionuar kompresori, pompat evakumit është 10 °C ÷ 40 °C. Gjithashtu është parashikuar që të bëhet ndërimi i ajrit në mënyrë të vazhdueshme. Ky impiant është projektuar i veçantë dhe është i destinuar vetëm për impiantin e gazrave mjeksore dhe është parashikuar impiant shuarje zjarri specifik shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse kundra zjarrit.

Ambienti teknik ku janë pozicionuar pajisjet e gazit mjeksor ndodhet në ambientet e rikonstruktuar per kete funksion dhe i plotëson kushtet teknike, sipas normave dimensionale dhe ndertimore, normave të temperaturës, lagështisë, ventilimit natyral të vazhdueshëm të ambientit. Gjithashtu respekton distancat midis bombolave për çështje sigurie dhe distancën ndërmjet godinës (bombolat e oksigjenit janë rreth 25m larg godinës së spitalit), janë të pajisura me pajisjet furnizuese rezerve dhe emergjence, të cilat janë destinuar vetëm për impiantet e gazit mjekesor. Kalimi i linjave nga godina teknike deri në godinën e spitalit bëhet nëpërmjet

Dokumentat Standarte të Tenderit

kolektorëve që arrin në centralin e reduktimit të shkallës së parë të gazit mjekësor të vendosur në hyrje të spitalit/reparteve.

Nga ky nënstacion niset rrjeti i shpërndarjes për të gjithë destinacionet për spitalin me rrjetin reduktimit të shkallës së dytë, me pajisjet ndërmjetëse të kompletuar me sistemin e alarmit etj., me rrjetin e tubacioneve të shpërndarjes deri tek daljet për përdoruesit, prizat e lidhjes të testuletave ose konsolat, etj. Rrjeti i shpërndarjes është konform normave të instalimit, dhe materiali i tubave sipas karakteristikave të përcaktuara në normat dhe kushtet teknike.

Sistemi i shpërndarjes të gazit mjekësor është në përputhje me kompartmentizimin e zjarrit dhe siguron ndërprerjen e furnizimit të gazit përmes pajisjes mbyllëse manuale të vendosur jashtë çdo kompartimenti. Gjithashtu sistemi është i pajisur edhe me tregues në rast ndërprerje apo ndërhyrje në sistem.

Grafiku i Punimeve:

GRAFIKU I PUNIMEVE SHITES											
Objekti : "Rikonstruksion i godinës së pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës"											
NR.	PERSHKRIMI I PUNIMIT	MUAJ 1				Muaj 2				MUAJI 3	
		Java 1	Java 2	Java 3	Java 4	Java 5	Java 6	Java 7	Java 8	Java 9	Java 10
I.	PUNIME FASADE OBJEKTI										
II.	NDERTIM TUALETE TE REJA NE DHOMA										
III.	PAISJE SANITARE NE WC E OBJEKTIT										
IV.	PUNIME SISTEMIMI TE JASHTME										
V.	KONDITIONIMI SISTEMI VRF										
VI.	PUNIME TE ASHENSORI RI										
VII.	PUNIME TE NDRYSHME NE OBJEKT										
VIII.	MONTIM PAISJE RRJETI OKSIGJENIT + RRJETI SANITAR										

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 13*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

PREVENTIV I MIRATUAR I FONDIT SHITESH
Emertimi i Objektivit: "RIKONSTRUKSION I SPITALIT TE PEDIATRISE,
DURRES"

NR	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA
I. PUNIME FASADE OBJEKTI			
2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (muret e jashteme)-FASADA	m2	2840
An	Veshje me polisterol me rezine (konturet dritareve dhe daljet ne fasade)	ml	770
4.2/p	Pergatitje konstruksione kapriata me shume profile - STREHA	ton	1.45
2.358/d	Veshje muri me kartonxhes cimentato (Fasade+strehe)	m2	98
An	Veshje fasade me alukoband	m2	64
An	Struktura Brisole ne fasade dhe dritare te objektit (alumini)	m2	105
2.373	Vetrato xhami i temperuar (Parapetet e Ballkonit)	m2	78
2.203	Veshje kornize llamarine xingat	m2	145
SHUMA 1			
II. NDERTIM TUALETE TE REJA NE DHOMA			
2.426	Prishje mure me tulla pa pastrim muri	m3	22
2.84	Mur me tulle me 8 vrima, t=10cm, h~3m, llaç perzier M15	m3	16.5
2.31	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m2	470
2.196	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1 shtrese k katrama (nyje sanitare)	m2	65
An	Veshje me pllaka qeramike cilesi e pare ne nyje sanitare	m2	255
2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re	m2	200
2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e I-re. (WC-te e reja)	m2	32
2.297/a	Tavan me kartonxhes	m2	40
2.37/5b	Transport mbetje ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	22
2.491/c	F+V Tuba PPR3 Ø32 (1 1/4")	ml	82
2.491/a	F+V Tub PPR3 (Ø25)	ml	120
2.491/b	F+V Tub PPR3 (Ø20)	ml	220
2.516	F+V Pjese pastrimi plastmasi P.P. P=6 ATM D110mm	Ton	0.056
2.516	F+V Tuba plastmasi P.P. Kanalizimi P=6 ATM. D75P	Ton	0.155
2.516	F+V Tuba plastmasi P.P. Kanalizimi P=6 ATM. D50P	Ton	0.14
2.516	F+V Tuba plastmasi P.P. Kanalizimi P=6 ATM. D40P	Ton	0.222
2.515	F+V Pilete dysHEMEJE me sifon D50mm	cope	15

Dokumentat Standarte të Tenderit

An - 9	F.V Saraçineske PPR 1/2" (F+V Valvola me sferë P=10 kg/cm ² 1/2" DN15 PN10, komplet)	cope	15
2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	15
2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	15
An	Aspirator per WC	cope	11
Analize	F.V.Kabell FG7OM1,3x1.5mm ²	m	150
2.48	F.V. Tub vetshuares fleksibel I zi d=20	m	140
2.485/1	F.V. Celes ndricimi 16A 1 polar	cope	15
2.487/d	F.V. Kuti,suport,pllaket, 4M B/M	cope	15
2. a-130	F.V.Ndricules tip plafoniere, me llampe fluoreshente 40w,	cope	15
SHUMA 2			
III. SANITARE NE WC E OBJEKTIT			
2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	77
2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	36
2.507	F.V vaske dushi importi + grup	cope	7
An	F.V Aspirator per WC	cope	5
SHUMA 3			
IV. PUNIME SISTEMIMI TE JASHTME (pjesa jug-lindje)			
2.426/3	Prishje shtresa betoni dhe asfalti ekzistues (perpara)	m ³	82
2.523/1	F.V Tuba PVC f=200 mm te brinjezuar	m	140
3.212/c	Shtrese stabilizant t=15cm	m ²	730
3.222/2	Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri	m ²	735
3.226/1	Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri	m ²	735
2.426/6	Prishje mure beton/arme	m ³	16
3.62	Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka	m ²	80
3.618	Bordura betoni 20x35 cm	ml	105
2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 (per nivelimin e bordurave)	m ³	8.4
2.262/4	Shtrese betoni C 16/20 (per kuneta i=10%)	m ³	10.5
2.37/5a	Transport mbetje ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m ³	190
An	Pusete betoni kontrolli kanalizimi me kapak gize 1.0x1.0x1.0m (H=1.0 m)	cope	4
An	Kunete betoni me zgare gize 0.3x0.3x8.0m (L=8.0m)	cope	3
2.273	Shtrese pllaka mermeri graniti (2 cm per rampen + shkallet)	m ²	85
2.334	Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi deri 8 m (muret rrethimit)	m ²	550
2.404/1	Boje hidroplastike importi cilesi e I-re (muret e jashteme rrethimit)	m ²	550
An	Kunete betoni me zgare gize 0.3x 0.3 x 6.0m (L=6.0m)	cope	4

Dokumentat Standarte të Tenderit

An - 23	Pusete b/a shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	cope	6
3.98/a	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	100
2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	45
2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtrese k katrama	m2	120
An	Shtrese termoizoluese me polisterol t=5cm(Shtrese mbrojtese per kartamane)	m2	80
2.182	Konstruksione metalike te thjeshta(fasheta per fiksimin e katramase)	ton	0.24
An	F V tub drenazhi Ø 150 mm	ml	100
3.378	Ndertim drenazhi,mbushje me zhavor prodhuar mak	m3	125
An	FV gjeotekstil Sf - 49 (per mbeshjtjellje e tubit te drenazhit)	m2	180
2.261	Shtrese rere (per mbulimin e tubit te drenazhit)	m3	24
SHUMA 4			
V. KONDICIONIMI SISTEMI VRF			
An	F.V Degezime "Y" per lidhjen e pajisjeve me terminalin kryesor < 16 kw	cope	35
An	F.V Degezime "Y" per lidhjen e pajisjeve me terminalin kryesor > 35 kw	cope	2
An	Gaz R410 Dupont per mbushjen e sistemit hidronik	kg	37.5
An	Pulte komandimi per cdo njesi te brendshme	cope	34
An	F.V.Kabell FG7OM1, 3x1.5mm2, per lidhjen e paisjeve te brendshme	ml	850
SHUMA 5			
VI. PUNIME TE ASHENSORI RI			
4.2/p	Pergatitje konstruksione kapriata me shume profile - KONSTRUKSIONI	ton	4.45
2.401	Lyerje Boje vaji siperfaqe metalik	m2	340
An	Prishje solete b/a (streha + ashensoret)	m3	14
2.70/2	Mur me tulle te lehtesuara dopio deri 3m me llaç perzier M25 (t=25cm)	m3	33
2.31	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25 (kafazi)	m2	680
2.256/b	Mbulim çatie me panele sanduich (kafaz ashesnor ne tarrace)	m2	18
2.37/5b	Transport mbetje ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km	m3	22
SHUMA 6			
VII. PUNIME TE NDRYSHME NE OBJEKT			
Analize	F.V.Kabell FG7OM1,3x1.5mm2	ml	3,500
Analize	F.V.Kabell FG7OM1,3x2.5mm2	ml	3,000
An	F.V.Kabell FG7OM1, 5x25 mm2 - Lidhja paneleve me panel kryesor	ml	528

Dokumentat Standarte të Tenderit

An	F.V.Kabell FG7OM1, 3x70 + 50 +50 mm ² - Lidhja chiller-panel kryesor	ml	75
2.297/a	Tavan me kartonxhes	m ²	920
2.297/b	Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm	m ²	250
2.267/a	Shtrese me pllaka grez porcelanato	m ²	300
2.31	Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25	m ²	1,935
2.33	Patinim tavani + kollona me allçi (stuko)	m ²	1480
2.386/1	F V dyer te brendeshme metalike te blinduara. (Rrethimi jashtem + ambjent teknik)	m ²	34
	SHUMA 7		
	SHUMA PUNIMEVE 1-7 (pa TVSH)	leke	
	TVSH	leke	20%
I	SHUMA PUNIMEVE 1-7 (me TVSH)	leke	
	PAJISJE (me tvsh)		
	VIII. PAISJE - RRJETI OKSIGJENIT (me tvsh)		
An	F. Panel reduktimi te shkalles se dyte per 3 gaze (O ₂ , Ac , Vac)	cope	3
An	F. Panel reduktimi te shkalles se dyte per 2 gaze (O ₂ , Vac)	cope	1
	SHUMA 8 (me tvsh)		
	IX. PAISJE - RRJETI SANITAR (me tvsh)		
An	F. Pompe centrifugale per rjetin primar, prurje Q=41 m ³ /h dhe H=110m.	cope	1
An	F. Pompe qarkulluese per ciklin e ujit sanitar	cope	3
	SHUMA 9 (me tvsh)		
II	SHUMA E PAJISJEVE 8 - 9 (ME TVSH)		
I+II	SHUMA TOTALE (me TVSH)	leke	

Shtojca 14

[*Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[vendi dhe data]

[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
< **Emri** >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 15

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat Standarte të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME PUNËT PROCEDURA ME NEGOCIIM PA SHPALLJE PARAPRAKE TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS

Neni 1: Qellimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra me anë të procedurës me negociim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Nëse kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jetë dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
